



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS

Neni 1

Me këtë Vendim, **Gani Bajrami**, Drejtorati për Arsim, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës së OJQ-së përfituese të subvencioneve **Voice of Roma Ashkali and Egyptians**, për Thirrjen publike Nr.4-453/01-6476 të datës 04.02.2026 "Për ofrimin e mbështetjeje financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve që drejtojnë qendra mësimore që mbështetin nxënësit Rom, Ashkali dhe Egjiptian si dhe nxënës të tjerë që kontribuojnë në arritjen arsimore" , të shpallur nga Drejtorati për Arsim.

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratës së OJQ-së përfituese të subvencioneve Voice of Roma Ashkali and Egyptians, konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës Gani Bajrami dhe Drejtorati për Arsim.

1Nr. 112/02-14121
Lipjan, më 26.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS

Neni 1

Me këtë Vendim, **Bekim Zaskoku**, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës së OJQ-së përfituese të subvencioneve **YHR**, për Thirrjen publike Nr.5-453/01-469 të datës 06.01.2026, të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratës së OJQ-së përfituese të subvencioneve **YHR**, konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës **Bekim Zaskoku** dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 030/01-15003

Lipjan, më 31.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe Ligjit Nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, Ligjit Nr.06/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.L-179 për transportin rrugor si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM
PËR FORMIMIN E GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E DRAFT-PLANIT PËR
TRANSPORTIN RRUGOR TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1
Përbërja

Formohet, grupi punues për hartimin e Draft-Planit për Transport rrugor të Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Sead Aliu, Kryesues
2. Rafete Retkoceri, anëtar
3. Vlora Krasniqi, anëtare
4. Salihe Marevci, anëtare
5. Bujar Curri, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë që në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse të hartojë Draft- Planin për Transport rrugor të Komunës së Lipjanit
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim të hapur publik duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjëse për konsultim publik.
3. Punët administrative – teknike për grupin punues do t'i kryej Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

1Nr. 020/04-14699
Lipjan, më 30.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM

PËR FORMIMIN E GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E DRAFT-PLANIT PËR REAGIM EMERGJENT NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Përbërja

Formohet, grupi punues për hartimin e Draft-Planit për Reagim Emergjent në territorin e Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Sead Aliu, Kryesues
2. Rafete Retkoceri, anëtare
3. Gafurr Hetemi, anëtar
4. Vlora Krasniqi, anëtare
5. Sadri Shamolli, anëtar
6. Sazana Demiri Rexhepi, anëtare
7. Jetmir Bytyqi, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë që në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse të hartojë Draft- Planin për Reagim Emergjent në territorin e Komunës së Lipjanit.
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim të hapur publik duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjëse për konsultim publik.
3. Punët administrative – teknike për grupin punues do t'i kryej Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

1Nr. 020/04-14698
Lipjan, më 30.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 44 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, nenit 17 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) nr.25/2020 për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM

PËR FORMIMIN E GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E DRAFT-PLANIT PËR
VLERËSIMIN E RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË
TJERA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1 Përbërja

Formohet, grupi punues për hartimin e Draft-Planit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Sead Aliu, Kryesues
2. Rafete Retkoceri, anëtare
3. Gafurr Hetemi, anëtar
4. Vlora Krasniqi, anëtare
5. Albert Mustafa, anëtar
6. Bekim Zaskoku, anëtar
7. Jalldyze Gashi, anëtare
8. Afrim Sadiku, anëtar
9. Behar Mjeku, anëtar
10. Enver Elshani, anëtar
11. Sadri Shamolli, anëtar
12. Sazana Demiri Rexhepi, anëtare
13. Mexhide Gashi, anëtare

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë që në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse të hartojë Draft- Planin për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit.

2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim të hapur publik duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjëse për konsultim publik.
3. Pas finalizimit të Draft- Planit, grupi punues është i obliguar që draftin final përmes Kryetarit të Komunës ta dërgojë paraprakisht në AME -Agjencia e Menaxhimit Emergjent për shqyrtim profesional dhe përmbajtësor dhe pas marjes së opinionit nga AME e procedon për miratim në Kuvendin Komunal.
4. Punët administrative – teknike për grupin punues do t'i kryej Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Draft-Planit për vlerësimin e rrezeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit 1Nr.020/01-21360 i datës 28.04.2026.

1Nr. 020/04-14693
Lipjan, më 30.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 78 të Ligjit të punës Nr. 03/L-212 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës nxjerr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE NGA LËMIA E ARSIMIT

Neni 1

Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të stafit arsimor të Komunës së Lipjanit, në këtë përbërje:

1. Jakup Bahtiri, Kryesues
2. Mexhide Gashi, anëtare
3. Behar Aliu, anëtar

Neni 2

Detyrë e Komisionit është shqyrtimi i ankesave nga marrëdhënia e punës të stafit arsimor të cilët vlerësojnë se u janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës duke përjashtuar ankesat e aplikantëve për punësim në Arsim ..

Komisioni ka për detyrë që ankesat ti shqyrtojë dhe të vendosë brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit .

Neni 3

Mandati i Kryesuesit dhe anëtarit të dytë të Komisionit është dy vite.

Neni 4

Punët e pranimit të ankesave dhe punët tjera administrativo-juridike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Arsim.

Neni 5

Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi menjëherë .

INr. 020/04-11920
Lipjan, më 10.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmet





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 14 Rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit Nr.15-670/01-22599 të datës 28.04.2023 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR BURSAT E
STUDENTEVE

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të studenteve të cilët janë ankuar ndaj listës preliminare të shpallur nga Komisioni vlerësues për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit për vitin akademik 2025/2026, Nr.4-670/01-13716 datë 24.03.2026, në këtë përbërje:

- 1.Liridon Duhlaku, Zyrtar Ligjor në Drejtoratin për Arsim
- 2.Emine Mustafa Deliu, Zyrtare në Sektorin për Përfaqësim dhe Çëshje Ligjore
- 3.Albulena Salihu, Zyrtare në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësit

1. Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëjë shqyrtimin e ankesave të studenteve të cilët janë ankuar ndaj listës preliminare Nr.4-670/01-13716 datë 24.03.2026 të shpallur nga Komisioni vlerësues për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Lipjanit për vitin akademik 2025/2026. Komisioni do të shqyrtoj ankesat në bazë dispozitave të Rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit Nr.15-670/01-22599 të datës 28.04.2023 si dhe kritereve të konkursit për ndarjen e bursave Nr.4-610/01-4218 të datës 27.01.2026.
2. Punët teknike administrative për Komisionin do të kryhen nga Drejtorati për Arsim.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe më të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-14123
Lipjan, më 26.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmet





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr.15-016/01-63314, e datës 26.12.2024, Kryetari i Komunës nxjerr,

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT-PLANIN KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR TË ZHVENDOSURIT DHE ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME 2026-2028 NË KOMUNËN E LIPJANIT.

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Projekt-Plani Komunal i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2026-2028 në Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Projekt - Plan Komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2026-2028 në Komunën e Lipjanit ose në email adresën shkelzen.Hajdini@rks-gov.net, më së largu me datë 26.03.2026.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 016/01-12221
Lipjan, më 12.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **10,360.00€**, (dhjetëmijë e treqind e gjashtëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/04-10569 e datës 02.03.2026, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 37 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin shkurt të vitit 2026 me nga 280 euro për secilin rast $37 \times 280 = 10,360.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/04-10569
Lipjan, më 03.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e listës përfundimtare për OJQ-të për Thirrje publike “Për ofrimin e mbështetjeve financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve që drejtojnë qendra mësimore që mbështetin nxënësit Rom, Ashkali dhe Egjiptian si dhe nxënës të tjerë që kontribuojnë në arritjen arsimore” në Komunën e Lipjanit Nr.4-453/01-6476 të datës 04.02.2026, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ “VOICE OF ROMA ASHKALI AND EGYPTIANS”

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **12,000.00 €** (dymbëdhjetëmijë euro), për t'a mbështetur financiarisht **OJQ**-në “Voice of Roma Ashkali and Egyptians”, e cila ka aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.4-453/01-6476 të datës 04.02.2026 “Për ofrimin e mbështetjeve financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve që drejtojnë qendra mësimore që mbështetin nxënësit Rom, Ashkali dhe Egjiptian si dhe nxënës të tjerë që kontribuojnë në arritjen arsimore” të shpallur nga Drejtorati për Arsim.

2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja e cila do të mbështetet financiarisht nga Komuna.

Nr.	Emërtimi i OJQ-së	Shuma
1.	VOICE OF ROMA ASHKALI AND EGYPTIANS	12,000.00 €
	Shuma Totale	12,000.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2026 të Drejtoratit për Arsim.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen në kontratë e cila do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 453/01-12683/2
Lipjan, më 17.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues Nr.05-453/01-14742 të datës 30.03.2026 për shpalljen e listës përfundimtare për OJQ-në përfituese sipas “Thirrjes publike për mbështetje financiare për aktivitetet “ Implementimi i Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në komunën e Lipjanit, si dhe Implementimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2025-2027 në komunën e Lipjanit” me Nr.5-453/01-469 të datës 06.01.2026, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ –Y A H R

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 38.000.00 (tridhjet e tetëmijë euro) për subvencionimin e organizates joqeveritare e cila ka aplikuar sipas: “Thirrje publike për mbështetje financiare në Nr.5-453/01-469 të datës 06.01.2026”, të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja- e cila është shpallur përfituese .

Nr.	Emërtimi i OJQ-së	Shuma
1.	Y A H R	38.000.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2026 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

1. Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen në kontratë e cila do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese.

2. Kontrata do të lidhet vetëm me atë OJQ e cila para nënshkrimit të Kontratës ka paraqitur Prova se menaxheri i projektit nuk është nën hetime për vepra penale si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara ashtu siq precizohet edhe në Thirrjen e cekur publike.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

INr. 453/01-14742/2
Lipjan, më 31.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT MBI PËRCAKTIMIN E POZICIONEVE PËR FURNIZIM ME KARTELA MBUSHËSE PËR TELEFONA MOBIL PËR VITIN 2026 1Nr.030/01-2572 I DATËS 19.01.2026

I. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet pika I e Vendimit mbi përcaktimin e pozicioneve për furnizim me kartela mbushëse për telefonat mobil për vitin 2026, 1Nr.030-01-2572 i datës 19.01.2026 si vijon:

Pika e I, te pjesa tabelare, numri rendor 16, pozicioni i punës Menaxher të projekteve-kontrateve (Drejtoria për Infrastrukturë) nga numri i kryersve 3 shtohen edhe 2 kyersë tjerë përkatësisht 5 kryersë gjithsej ashtu që numri rendor 16 merr këtë përmbajtje:

Nr	Funksioni	Nr i Kryersve	Shuma mujore
16.	Menaxher të projekteve- kontrateve (Drejtoria për Infrastrukturë)	5	10 €

II.Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin të njoftohet, Drejtoria për Infrastrukturë dhe Menaxheri i Kontratës Behar Aliu.

1Nr.030/01-2572/3
Lipjan, më 23.03.2026

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT MBI PËRCAKTIMIN E POZICIONEVE PËR FURNIZIM ME KARTELA MBUSHËSE PËR TELEFONA MOBIL PËR VITIN 2026 1Nr.030/01-2572 I DATËS 19.01.2026

I. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet pika I e Vendimit mbi përcaktimin e pozicioneve për furnizim me kartela mbushëse për telefonat mobil për vitin 2026, 1Nr.030-01-2572 i datës 19.01.2026 si vijon:

Pika e I te pjesa tabelare, pas numrit rendor 20 shtohet pozicioni i ri Komandant i Njesisë së Zjarrëfikësve – Lipjan në numrin rendor 21 me këtë përmbajtje:

Nr	Funksioni	Nr i Kryersve	Shuma mujore
21.	Komandant i Njesisë së Zjarrëfikësve – Lipjan	1	10 €

II.Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin të njoftohet, Komandant i Njesisë së Zjarrëfikësve – Lipjan, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Menaxheri i Kontratës Behar Aliu.

1Nr.030/01-2572/2

Lipjan, më 10.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, me qëllim të rritjes së transparencës, përgjegjësisë institucionale, standarizimit të shërbimit publik dhe lehtësimit ndërmjet administratës komunale dhe qytetarëve, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM

PËR PAJISJEN ME ID - IDENTIFIKUESE DHE MBAJTJEN E SAJ GJATË ORARIT TË PUNËS NGA ZYRTARËT PUBLIKË TË ADMINISTRATËS KOMUNALE

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Vendimi është sigurimi i identifikimit të qartë të zyrtarëve publikë gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare në funksion të rritjes së besimit të qytetarëve dhe pëmirësimit të kulturës institucionale.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky Vendim zbatohet për të gjithë zyrtarët publik dhe punonjësit administrativë në administratën e Komunës së Lipjanit pavarësisht pozitës apo drejtoratit përkatës.

Neni 3

Obligimi për paisje dhe mbajtje

1. Të gjithë të punonjësit obligohen të paisen me ID identifikuese zyrtare.
2. ID- duhet të bartet në vend të dukshëm gjatë gjithë orarit të punës dhe gjatë komunikimit me qytetarët apo palët.
3. Mbajtja e ID-së konsiderohet pjesë e standardit profesional të paraqitjes në shërbimin publik.

Neni 4

Forma dhe përmbajtja

1. Forma, dizajni, dimensionet dhe përmbajtja e ID-së përcaktohen dhe aprovohen nga Sektori i Personelit.

2. ID-ja duhet të përmbajë së paku:

- Emri dhe mbiemrin
- Pozitën zyrtare
- Drejtoratin përkatës
- Emrin dhe stemën zyrtare të Komunës.

3. ID-ja duhet të jetë e punuar në formë praktike dhe funksionale për bartje të përditshme.

Neni 5 **Përgjegjësitë për zbatim**

1. Sektori i Personelit obligohet të realizojë dizajnimin dhe paisjen me ID brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi.
2. Drejtorët e drejtorateve komunale janë përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit në njësitë përkatëse organizative.

Neni 6 **Mosrespektimi**

Mosrespektimi i obligimeve të përcaktuara me këtë Vendim trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregullat e brendshme disiplinore të administratës komunale.

Neni 7 **Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

1Nr. 030/01-12517
Lipjan, më 13.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në kërkesën e Drejtoreshës së Drejtoratit për Administratë Nr.01-016/01-14460 të datës 27.03.2026, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM

PËR RIAKTIVIZIMIN E NUMRIT KONTAKTUES PA PAGESË PËR INFORMIMIN E QYTETARËVE

- I. Me këtë Vendim me qëllim të ofrimit më të shpejtë dhe më efikas të informatave për qytetarët e Komunës së Lipjanit **Riaktivizohet** numri kontaktues pa pagesë.
- II. Numri kontaktues pa pagesë është: **080014000**
- III. Për funksionalizimin dhe menaxhimin e këtij numri si zyrtar përgjegjës caktohet:
 - BURIM GASHI, Udhëheqës i Sektorit për Administratë
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Vendimi i dërgohet:

Drejtoratit për Administratë
Burim Gashi

1Nr. 016/01-14460
Lipjan, më 30.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 4 dhe 7 të Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Bashkëfinancimin e Projektit "Farat e Fuqizimit: Gratë në Agrikulturë" 1Nr.320/01-10945 të datës 04.03.2026 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Fondacionit Jahjaga, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

1. Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej 500 € (pesëqind euro), konform dispozitave të Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Bashkëfinancimin e Projektit "Farat e Fuqizimit: Gratë në Agrikulturë" 1Nr.320/01-10945 e datës 04.03.2026 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Fondacionit Jahjaga.

2. Ndarja e mjeteve të cekura në paragrafin 1 të këtij neni bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Bashkëfinancimin e Projektit "Farat e Fuqizimit: Gratë në Agrikulturë" 1Nr.320/01-10945 e datës 04.03.2026 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Fondacionit Jahjaga në kuadër të cilit Projekt do të përfitojnë shtatë (7) gra nga Komuna e Lipjanit.

Neni 2

Fondacioni Jahjaga do të raportoj me shkrim Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim, lidhur me veprimet e ndërmarra, konform dispozitave të Marrëveshjes ku përfshihet Raporti narrativ dhe financiar së bashku me dokumentacion tjetër përkatës.

Neni 3

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për vitin 2026 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari në xhironlogarinë bankare të Fondacionit Jahjaga nr 1701001600101156 në NLB BANK.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 400/01-11179
Lipjan, më 05.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

